

Vendim nr. 88 datë 26.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 26.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ALI TOSKAJ**, përfaqësuar me prokurë nga avokat Zenun Hajdarmataj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1021, datë 13.06.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dërguar për gjykim përpara asaj gjykate procedimin penal nr. 281/2013, në ngarkim të të pandehurve Ali Toskaj (*kërkuesi*) dhe tre shtetaseve të tjerë për kryerjen e disa veprave penale, si: “Vrasja”, “Vjedhja me armë” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 76, 140 dhe 278 të Kodit Penal (*KP*).

2. Pas shqyrtimit gjyqësor, sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 639, datë 23.11.2015, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për veprat penale: (i) “Vrasja me dashje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 76, 22 dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim; (ii) “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278 i KP-së, dhe dënimin e tij me 9 vjet burgim; (iii) “Vjedhja me armë”, e kryer në bashkëpunim, dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim. Gjykata e rrethit, në bazë të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, ka vendosur dënimin e kërkuesit me 24 (njëzetë e katër) vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) është vendosur zbritja e 1/3-ës së masës së dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 16 vjet burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit të vendimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë se zakonshme.

3. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kanë paraqitur ankim prokurori lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale dhe masën e dënimit për dy të pandehurit e tjerë në gjykim, si dhe, mes të tjerëve, mbrojtësi i kërkuesit, i caktuar me prokurë të posaçme të datës 24.07.2014, që ka kërkuar deklarinin fajtor dhe dënimin e tij vetëm për veprën penale “Vjedhja me armë”. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 403, datë 16.06.2016, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e akteve për rigjykim po në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se në vendimin e gjykatës së rrethit duhet të gjejnë pasqyrim të gjitha elementet e vendimit, sipas nenit 383 të KPP-së.

4. Pas rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 277, datë 02.05.2017, për kërkuesin ka vendosur deklarinin fajtor për veprat penale: (i) “Vrasja me dashje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim; (ii) “Vjedhja me armë”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit M.S., dhe dënimin me 10 vjet burgim; (iii) “Vjedhja me armë”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, në dëm të shoqërisë “Bankers Petroleum” sh.a. dhe

dënimin me 10 (dhjetë) vjet burgim; (iv) deklarinim fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278 i KP-së dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim; Në bazë të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, gjykata ka vendosur dënimin e kërkuesit me 24 (njëzetë e katër) vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të KPP-së është vendosur zbritja e 1/3-ës së masës së dënimit dhe përfundimisht ai është dënuar me 16 vjet burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit të vendimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

5. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe kërkuesi nëpërmjet mbrojtësit të caktuar me prokurë të posaçme të sipërcituar.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 89, datë 13.02.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 277, datë 02.05.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

7. Kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të caktuar me prokurë të posaçme, ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat për paraqitjen e rekursit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 9, datë 18.02.2020, ka rivendosur në afat rekursin e kërkuesit ndaj vendimit nr. 89, datë 13.02.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

8. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, në datën 28.03.2018, kanë ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kërkuesi në datën 22.04.2020 (pas rivendosjes në afat) nëpërmjet mbrojtësit të caktuar me prokurë të posaçme. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1021, datë 13.06.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve, pasi nuk përmbanin asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së.

9. Aktualisht kërkuesi ndodhet në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier dhe në datën 31.01.2024 (data e shërbimit postar), nëpërmjet avokatit të caktuar me prokurë të posaçme, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili pas plotësimit të dokumenteve është regjistruar përfundimisht në datën 04.03.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për t’u njoftuar, për t’u mbrojtur dhe dëgjuar*, pasi për vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së

Shkallës së Parë Vlorë, që e kishte dënuar me 16 vjet burgim, ai ka marrë dijëni në datën 24.04.2019. Gjatë gjykimit në shkallë të parë kërkuesi ka qenë në mungesë dhe i përfaqësuar nga mbrojtësi, për të cilin nuk kishte akt përfaqësimi, pasi ai ka qenë jashtë vendit në kohën që është hartuar prokura në Shqipëri, gjë që vërtetohet nga sistemi TIMS. Kërkuesi gjatë gjykimit në shkallë të parë ka qenë i përfaqësuar nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur me prokurë. Gjatë gjykimit në shkallë të parë kërkuesi nuk ka pasur njoftime të rregullta, madje nuk ka autorizuar avokatin e caktuar me prokurën e datës 24.07.2014 për të kërkuar gjykimin e shkurtuar. Në gjykatën e apelit mbrojtësi ka paraqitur ankim pa i dhënë tagra për përfaqësimin në atë gjykatë. Gjatë procedimit është shkelur neni 34/a i KPP-së, që parashikon të drejtat e të pandehurit dhe neni 48 i po këtij kodi, që parashikon zgjedhjen e mbrojtësit nga i pandehuri. Gjykata ka shkelur kërkimet sipas nenit 352, paragrafi 1, të KPP-së, sipas të cilit, pas kërkimeve të të pandehurit, në rast se nuk paraqitet në seancë dhe rezulton se nuk ka marrë dijëni personalisht për gjykimin, gjykata vendos pezullimin dhe urdhëron Policinë Gjyqësore të vazhdojë me kërkimet deri në 1 vit. Gjatë gjykimit në apel kërkuesi nuk është njoftuar për asnjë seancë dhe gjykata e apelit është mjaftuar me caktimin e mbrojtësit kryesisht. Kërkuesi nuk ka pasur mundësi të argumentojë se ekzistonin faktorë lehtësues, si pendimi pas kryerjes së krimit, vështirësitë ekonomike të familjes së tij, të cilat do të kishin ndikuar në një dënim më të ulët. Kërkuesi nuk ka pasur dijëni për gjykimin në gjykatën e apelit, pasi nuk është njoftuar dhe i është caktuar avokat kryesisht, i cili jo vetëm nuk e ka njoftuar për gjykimin dhe vendimin e marrë, por nuk ka ushtruar as rekurs. Kërkuesi, pasi ka marrë dijëni në datën 24.04.2019, brenda afatit 10-ditor, nëpërmjet mbrojtësit tjetër Z.H., të caktuar me prokurë të posaçme, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë me kërkesë për rivendosjen në afat për paraqitjen e rekursit.

10.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me një trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, kur në fakt duhet ta shqyrtonte një trup gjykues i përbërë nga 5 gjyqtarë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kishte të drejtë ta gjykonte çështjen në themel, nëse do të gjykohej e nevojshme, por duhet ta shqyrtonte në seancë gjyqësore.

10.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në rekurs ishin parashtruar pretendime të natyrës procedurale, për të drejtën për t'u mbrojtur gjatë gjykimit si në shkallë të parë, ashtu edhe në apel. Gjatë gjykimit në apel mbrojtësi i zgjedhur ka hequr dorë nga mbrojtja pa e njoftuar kërkuesin. Gjykata e Lartë e ka anashkaluar këtë fakt dhe ka arsyetuar se gjykata e apelit ka vepruar drejt duke njoftuar familjarët e kërkuesit dhe caktuar mbrojtës kryesisht. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, për sa u përket rasteve të gjykimit në mungesë, njoftimit për herë të parë të të pandehurit sipas nenit 140 i KPP-së ose njoftimit për të pandehurin që nuk gjendet, sipas nenit 141 të po këtij kodi, çka çon në pavlefshmëri të njoftimit sipas nenit 143. Pretendimet e parashtruara në rekurs lidheshin me ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave më të ulëta për sa i përket “konkurrimit të veprave penale” dhe Gjykata e Lartë ka anashkaluar dhe nuk ka analizuar elementet e anës objektive dhe subjektive, duke cenuar edhe *parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale*, pasi, në rastin konkret, kërkuesi ka pasur qëllim vetëm konsumimin e një veprë penale, e cila përthith edhe veprën tjetër për të cilën është akuzuar dhe nuk mund të dënohet për të dyja këto vepra. Për të njëjtin fakt nuk mund t'i atribuohet më shumë se një shkelje e normës, kur vetë ajo është e mjaftueshme në raport me marrëdhënien juridike të cenuar dhe përmban elementet e veprës penale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të

pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë/i dënuar në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues .

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar (*shih vendimet nr. 11, datë 28.02.2024; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar dhe për t’u mbrojtur gjatë gjykimin në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit, si dhe për cenimin e gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale në Gjykatën e Lartë.

15. Kolegji vëren se nga përmbajtja e ankimit të paraqitur në Gjykatën e Apelit Vlorë kërkuesi nuk e ka parashtruar pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur gjatë gjykimin në shkallë të parë ose të ketë kundërshtuar prokurën e lëshuar në emër dhe për llogari të avokatit që e ka përfaqësuar atë gjatë gjykimin në shkallë të parë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u mbrojtur gjatë gjykimin në shkallë të parë kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

16. Për pretendimet e tjera në lidhje me cenimin e së drejtës për t’u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar gjatë gjykimin në apel, gjykimin nga një gjykatë të caktuar me ligj, kërkuesi i ka parashtruar në rekurs. Ndërsa për pretendimet për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale në Gjykatën e Lartë ai nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Konstatohet se vendimi më i fundit në kohë i

kundërshtuar nga kërkuesi mban datën 13.06.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 01.02.2024. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkuesi ka pretenduar se ka marrë dijëni në datën 13.10.2023, kur vendimi i është dërguar nëpërmjet *e-mail-it* mbrojtësit të tij.

18. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se si datë e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e tij, në rastin e procesit gjyqësor, është data e marrjes dijëni efektivisht për vendimin gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim i Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijëni për vendimin gjyqësor është ajo kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare të saj ose përmes njoftimit elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në vijim, për qëllim të shqyrtimit kushtetues të çështjes është administruar dosja gjyqësore. Nga materialet e saj ka rezultuar se Gjykata e Lartë në datën 16.10.2023 i ka komunikuar vendimin avokatit Z.H., në adresën e postës së tij elektronike, i cili ka paraqitur edhe ankimin kushtetues individual në Gjykatë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nisur nga data 16.10.2023, paraqitja e ankimit kushtetues individual në datën 01.02.2024 është brenda afatit ligjor 4-mujor dhe kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

20. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe të parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale.

21. Fillimisht, për pretendimin për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kishte të drejtë ta gjykonte çështjen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, por me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, Kolegji evidenton se nga përmbajtja e dispozitave procedurale penale rekursi shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve, bazuar në nenin 433, pika 2, të KPP-së. Ky kolegji verifikon legjitimitetin e kërkuesit, bazueshmërinë në ligj të rekursit, praninë e kriterëve ligjore për shqyrtimin e saj dhe në përfundim vendos mospranimin e tij nëse bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja

nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës për një proces të rregullt, për sa kohë që Kolegji Penal ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe nuk do të merret në shqyrtim.

22. Pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale, janë të garantuara në nenet 42 dhe 34 të Kushtetutës dhe *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës. Kolegji vlerëson se në thelb pretendimi për cenimin e parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale lidhet me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë, për rrjedhojë do të analizohet së bashku me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur

23. Kërkuesi ka pretenduar se në gjykatën e apelit mbrojtësi ka paraqitur ankim pa i dhënë tagra për përfaqësim në atë gjykatë. Gjatë gjykimit në apel kërkuesi nuk është njoftuar për asnjë seancë dhe gjykata e apelit është mjaftuar me caktimin e mbrojtësit kryesisht, i cili nuk ka ushtruar as rekurs. Kërkuesi, pasi ka marrë dijeni në datën 24.04.2019 për vendimin e gjykatës së apelit, brenda afatit 10-ditor, nëpërmjet mbrojtësit të caktuar me prokurë të posaçme Z.H., i është drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë me kërkesë për rivendosjen në afat për paraqitjen e rekursit. Kërkuesi nuk ka pasur mundësi të argumentojë se ekzistonin faktorë lehtësues, si pendimi pas kryerjes së krimit, vështirësitë ekonomike të familjes së tij, të cilat do të kishin favorizuar një dënim më të ulët.

24. Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve. Veçanërisht në procesin penal mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të cilat së bashku, në vetvete, përbëjnë elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre,

gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese dhe ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Kolegji rithekson qëndrimin e mbajtur nga Gjykata se realizimi substancial i mbrojtjes së individit është, në radhë të parë, përgjegjësi e mbrojtësit që pranon detyrën e caktuar, duke vijuar më tej me përgjegjësinë që ka Dhoma e Avokatisë, e cila, në kuadër të vetërregullimit, ka për detyrë të mbikëqyrë dhe të kujdeset për veprimtarinë profesionale që ushtron mbrojtësi (*shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, mbrojtja nga një avokat i caktuar kryesisht, që i ofrohet individit në procesin penal, është pjesë e skemës së mbrojtjes së detyrueshme që ofrohet nga shteti konform nenit 49 të KPP-së (*shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi është hetuar në mungesë me masë sigurimi “Arresti në burg” për kryerjen e disa veprave penale, si vrasja me dashje, vjedhja me armë dhe prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake. Nga dosja gjyqësore, sipas procesverbaleve “Për kërkimin e personit që nuk gjendet” të datave 15.01.2014, 21.02.2014, 04.03.2014, ka rezultuar se kërkuesi nuk gjendej në banesë, por ndodhej në Greqi. Procesverbalet rezultojnë të jenë të firmosura nga oficerë të Policisë Gjyqësore, si dhe në një rast nga babai dhe në tjetrin nga nëna e kërkuesit. Pas kryerjes së veprimeve për gjetjen e personit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në bazë të nenit 247 të KPP-së, me vendimin nr. 145, datë 06.03.2014, ka vendosur deklarinimin e ikjes së kërkuesit dhe ka caktuar avokatin G.G.

27. Lidhur me përfaqësimin në gjykimin në shkallë të parë rezulton se në dosjen gjyqësore ndodhet prokura e posaçme e datës 24.07.2014, sipas së cilës kërkuesi ka caktuar avokatin G.G., mbrojtësin e tij, për ta përfaqësuar gjatë gjykimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në të gjitha shkallët e gjykimin, duke pasur, mes të tjerave, edhe tagra për të paraqitur ankim, rekurs, si dhe kërkesë për gjykimin e shkurtuar. Në bazë të kësaj prokure, gjatë gjykimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë avokati G.G. ka paraqitur dhe kërkesën për gjykimin e shkurtuar (*shih faqen 7 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

28. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 277, datë 02.05.2017, ka vendosur, mes të tjerave, deklarinin fajtor të kërkuesit për veprat penale: (i) “Vrasja me dashje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim; (ii) “Vjedhja me armë”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit M.S., dhe dënimin me 10 vjet burgim; (iii) “Vjedhja me armë”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, në dëm të shoqërisë “Bankers Petroleum” sh.a. dhe dënimin me 10 (dhjetë) vjet burgim; (iv) deklarinin fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278 i KP-së dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim; Në bazë të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, gjykata ka vendosur dënimin e kërkuesit me 24 (njëzetë e katër) vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të KPP-së është vendosur zbritja e 1/3-ës së masës së dënimit dhe përfundimisht ai është dënuar me 16 vjet burgim.

29. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi nëpërmjet avokatit G.G. të caktuar me prokurën e posaçme të datës 24.07.2014, sipas së cilës, mes të tjerave, ka pasur edhe tagrin për të paraqitur ankim në gjykatën e apelit. Shkaqet e ankimit lidheshin me kualifikimin e gabuar të veprave penale, pasi, sipas kërkuesit, ai ka marrë pjesë në vjedhje, por nuk mund të akuzohet për veprat penale “Vrasja e mbetur në tentativë” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, si dhe ka parashtruar rrethanat për gjendjen e vështirë familjare, duke pasur edhe dy fëmijë të mitur.

30. Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë rezulton se kërkuesi dhe avokati i caktuar me prokurë janë njoftuar për zhvillimin e seancës së parë në datën 07.11.2017 (nga fletëthirrja rezulton se kanë firmosur babai i kërkuesit dhe avokati i caktuar me prokurën e posaçme). Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka konfirmuar se kërkuesi dhe avokati nuk janë paraqitur në seancë, megjithëse kanë marrë dijeni, ka caktuar avokat kryesisht dhe ka shtyrë seancën për t’i dhënë kohë realizimit të mbrojtjes. Në seancën e datës 21.11.2017 ka qenë i pranishëm avokati i caktuar me prokurë dhe pas kësaj seance avokati ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga mbrojtja, pasi familjarët e kërkuesit nuk kishin kryer pagesat përkatëse. Në seancën e radhës të datës 30.11.2017 Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore dhe njoftimin e kërkuesit për kërkesën e avokatit për heqjen dorë nga përfaqësimi i tij. Gjykata e apelit i ka komunikuar kërkuesit: (i) avokati i zgjedhur me prokurë kishte hequr dorë nga përfaqësimi; (ii) përcaktoni se nga cili avokat do të mbroheni në gjykim; (iii) seanca e ardhshme është caktuar për në datën 20.12.2017. Vendimi

është dërguar në adresën e banesës së kërkuesit në datën 02.12.2017 dhe mban shënimin “*Aliu ndodhet në burg në Greqi*”. Në vijim, në mungesë të një avokati të zgjedhur nga kërkuesi, gjykata e apelit në seancën e datës 20.12.2017 ka caktuar avokate kryesisht dhe i pranishëm ka qenë edhe babai i kërkuesit, i cili është shprehur se ai ndodhej në një burg të Patras, Greqi. Gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 31.01.2018, pas kërkesës së avokatit të njërit prej të pandehurve për t’u njohur me aktet. Në të dyja seancat e fundit ka qenë e pranishme avokatja e caktuar kryesisht, e cila ka kërkuar pezullimin e gjykimit, për shkak se i pandehuri nuk ka marrë dijeni, si dhe është shprehur se i qëndronte ankimit të paraqitur nga i pandehuri/kërkuesi. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 89, datë 13.02.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 277, datë 02.05.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

31. Në vijim, kërkuesi, pas rivendosjes në afat të rekursit, nëpërmjet mbrojtësit të caktuar me prokurë, ka paraqitur rekurs duke parashtruar pretendimet e tij për gjykimin në Gjykatën e Apelit Vlorë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1021, datë 13.06.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit. Në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar dhe mbrojtur, Kolegji Penal ka arsyetuar se interesat e kërkuesit në gjykimin në gjykatën e apelit janë mbrojtur nga një avokat i caktuar kryesisht, në përputhje me rregullat procedurale penale. Po sipas këtij kolegji, të pandehurit nuk i është mohuar e drejta për mbrojtje efektive dhe ndaj tij është zhvilluar një proces i rregullt ligjor (*shih paragrafët 33 dhe 34 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

32. Kolegji vëren se në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar kërkuesi ka qenë i përfaqësuar gjatë gjykimit me avokat të caktuar me prokurën e datës 24.07.2014, të lëshuar nga vetë ai që në fazën e hetimeve paraprake, gjë e cila tregon se ka qenë të dijeni të procesit penal që po zhvillohej ndaj tij. Në vijim, gjatë gjykimit, gjykatat, në rrethanat kur nuk ka qenë i pranishëm avokati i zgjedhur me prokurë, kanë caktuar avokat kryesisht.

33. Kolegji vëren se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, avokati i zgjedhur ka pasur tagrin për të paraqitur ankimin në apel dhe në kushtet kur mbrojtësi i caktuar me prokurën e posaçme nuk u përgjigjej familjarëve të kërkuesit, ata mund të kishin shfrytëzuar mundësinë për të komunikuar me të për caktimin e një mbrojtësi tjetër. Në këtë drejtim, konkretisht referuar procesverbaleve, Kolegji konstaton se gjatë procesit të zhvilluar në gjykatën e apelit të përfunduar me vendimin nr. 403, datë 16.06.2016, sipas të cilit çështja është kthyer për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ka qenë e pranishme bashkëshortja e kërkuesit, e cila

ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore me qëllim për t'i kërkuar bashkëshortit caktimin e një avokati tjetër. Po në gjykatën e apelit, pas rishqyrtimit nga gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 30.11.2017 kjo gjykatë i ka njoftuar familjarët për mundësinë për të zgjedhur mbrojtës, si dhe në seancën gjyqësore të datës 20.12.2017 në gjykatën e apelit ka qenë i pranishëm babai i kërkuarit.

34. Në vijim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se ndaj kërkuarit nuk vihet re të jenë lejuar shkelje procedurale në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar gjatë gjykimit në gjykatën e apelit. Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në atë gjykatë kërkuari ka qenë i përfaqësuar gjatë gjithë seancave gjyqësore me mbrojtës të caktuar me prokurën e posaçme ose të caktuar kryesisht, të cilët kanë pasur mundësi të debatojnë e kundërshtojnë provat e paraqitura, si dhe të paraqesin argumente e prova në mbështetje të pretendimeve të tij.

35. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar gjatë gjykimit në gjykatën e apelit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale

36. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi në rekurs ishin parashtruar pretendime që lidheshin me ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave më të ulëta, për sa i përket “konkurrimit të veprave penale”, dhe Gjykata e Lartë ka anashkaluar dhe nuk ka analizuar elementet e anës objektive dhe subjektive, duke cenuar dhe parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale. Në rastin konkret, kërkuari ka pasur qëllim vetëm konsumimin e njëres vepër penale, e cila përthith edhe tjetrën për të cilën është akuzuar dhe nuk mund të dënohet për dy vepra penale.

37. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Funkzioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsytimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se kur pretendimi lidhet me mënyrën e interpretimit të ligjit, ajo ndërhyt vetëm kur ai është arbitrar ose kur

konstaton gabim ligjor aq evident që të karakterizohet si një gabim që asnjë gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë, ose të jetë i tillë që të prishë drejtësinë e procesit (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta, sipas të cilit askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtin fakt që përbën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. *Kriteri “e njëjta vepër”* i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepre penale dhe kualifikim ligjor që formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Kolegji vëren se kërkuesi për vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë ka marrë dijeni në datën 24.04.2019 dhe ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të rekursit, për të cilën Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 9, datë 18.02.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës. Në vijim kërkuesi ka paraqitur rekurs dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1021, datë 13.06.2023, ka vendosur mospranimin e tij. Kolegji Penal ka arsyetuar se pretendimet janë fokusuar kryesisht në drejtim të zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal, konkretisht të dispozitave që lidhen me njoftimin e të pandehurit, duke pretenduar mohimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, që është analizuar më sipër (*shih paragrafin 31 të vendimit*).

40. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuesit, se ai nuk duhej të dënohej për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i KP-së, pasi kjo vepër nuk konkurren me veprën penale të parashikuar nga neni 140 i po këtij kodi. Sipas Kolegjit Penal, pretendimi është i pabazuar dhe në interpretim jo të drejtë të kuptimit e qëllimit të kësaj dispozite materiale penale, si dhe praktikës gjyqësore ose të unifikuar, të konsoliduar ndër vite. Kolegji Penal, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se nga përmbajtja e nenit 140 të KP-së rezulton se armëmbajtja pa leje është element përbërës i paragrafit të parë

të figurës së veprës penale “Vjedhja me armë”, por në çdo rast autori që kryen një vjedhje, në shoqërimin e armës pa leje, konsumon edhe figurën e veprës penale të armëmbajtjes pa leje. Me anë të kësaj figure të veprës penale ligji penal mbron në mënyrë të posaçme nga veprimet ose mosveprimet kriminale, dy marrëdhënie të rëndësishme juridike, të cilat janë pasuria dhe rendi ose siguria publike nga prodhimi ose mbajtja, shitja, blerja e armëve pa leje, por duhet theksuar se objekti kryesor në këtë rast është pasuria, ndërsa siguria publike është objekti dytësor, që përbën edhe elementin cilësues të veprës penale kryesore. Kolegji Penal ka theksuar se vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, e parashikuar nga neni 278, paragrafi 2, i KP, konkurren me veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, pasi në këtë të fundit vrasja e personit mund të bëhet edhe me mjete të tjera, prandaj vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake nuk është element thelbësor i veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, të parashikuar nga neni 141 i KP-së. Sipas Kolegjit Penal, në analizë të elementeve të veprave penale në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes objekt gjykimi, arsyetimi i dy gjykatave më të ulëta se kërkuesi ka konsumuar dy herë elementet e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 140 i KP-së, në lidhje me nenet 25 dhe 22 të po këtij kodi është i bazuar në ligj dhe prova. Në përfundim, Kolegji ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së (*shih paragrafët 36 -38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

41. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se referuar vendimit të Gjykatës së Lartë rezulton se nuk ka cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me respektimin e parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale. Sipas Kolegjit, në tërësi, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik, i pamjaftueshëm ose arbitrar në interpretimin e ligjit procedural dhe material. Për më tepër, Kolegji evidenton se forma e gjykimit në dhomën e këshillimit, pra jo me pjesëmarrjen e palëve, nuk ndikon në të drejtat e kërkuesit, për sa kohë që u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në rekurs.

42. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale, është haptazi i pabazuar.

43. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.